



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Drejtoria e Administratës Zgjedhore

Data

Nr. Prot

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR
DHËNIE AUTORIZIMI PËR NDËRRIMIN E VENDNDODHJES SË QV NR. 4589/00,
PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË HIMARË TË DATËS 4
GUSHT 2024

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Referuar neneve 62 pika 4 dhe 93, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 3, pikat 3 dhe 4, të Udhëzimit nr. 1, datë 5.12.2020, të Komisionit Rregullator, “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjes së hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”, vendndodhja e qendrës së votimit caktohet në të njëjtën adresë me atë të zgjedhjeve të fundit, me përjashtim të rastit kur për arsye objektive të parashikuara në nenin 93, kjo nuk është e mundur. KQZ-ja mund të caktojë qendra votimi në ndërtesa private kur nuk ka mundësi objektive për të përdorur një ndërtesë publike në zonën e qendrës së votimit ose në një zonë qendre votimi fqinje.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objektit që trajton ky projektvendim, vlerësohet se nga ana e ligjshmërisë është në kompetencë të Komisionerit për ta shqyrtuar.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Kryetari ne detyre i bashkisë Himare me shkresën nr. 3888/2 prot date 16.7.2024, ka sjelle informacion lidhur me caktimin e qendrave te votimit ne bashkinë Himare për zgjedhjet e datës 4 gusht 2024.

Ne këtë shkresë është përcaktuar se vendndodhja e qendrës se votimit nr. 4589/00 është me vendndodhje ne ambientin publik Rr. Xhorxh Tened, nr. 4, Shkolla Spile (shkolla 9-vjeçare “Nikolla Pano Meniko”).

KZAZ Nr. 88 nëpërmjet kryetarit te saj ka përcjelle ne KQZ shqetësimin se ambienti ne te cilin propozon pushteti vendor është jashtë hartës se zonës se qendrës se votimit nr. 4589/00 dhe e bën votimin dhe pjesëmarrjen te pa aksesueshme duke marre parasysh dhe moshën e madhe te shumicës se votuesve ne atë qendër dhe temperaturat e larta duke qene se dita e votimit është 4 gusht. Nga ana tjetër KZAZ ka pohuar dhe ka paraqitur deklarate nga pronari i ambientit privat z. Milo Odhisea, se



ofron një ambient tjetër ne pronësi të tij për të shërbyer si qendër votimi, duke qene se ambienti ku janë zhvilluar zgjedhjet ne vitet paraardhese janë kthyer ne dhoma pushimi. Distanca e ambientit te ri te propozuar nga ai qe ka qene ne zgjedhjet pararendëse është ne një distance prej shtate metrash nga qendra e mëparshme dhe sipas KZAZ plotëson kriteret ligjore për t’u përdorur si KQV.

Referuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 62, pika 4, nenin 93, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 3, paragrafët 3 dhe 4, të Udhëzimit të Komisionit Rregullator nr.1, datë 05.12.2020 “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjes së hartës së njësive të vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”, KQZ-ja mund të caktojë qendra votimi në ndërtesa private kur nuk ka mundësi objektive për të përdorur një ndërtesë publike në zonën e qendrës së votimit ose në një zonë qendre votimi fqinje.

Në lidhje me këto propozime nga ana e KZAZ nr. 88, KQZ ka kërkuar informacion nga Bashkisë Himarë, e cila ka informuar se vendndodhja e re nga vendndodhja e mëparshme dhe nga zonat ku banojnë zgjedhësit e kësaj QV-je është ne një distance prej 2500 metra. Bashkia pohon se vendndodhja e re e QV-së nuk është brenda zonës së saj të qendrës së votimit, dhe ka ndryshuar vendndodhjen për shkak nuk ka ambient publik dhe as privat qe mund te jepet me qera.

Nisur sa më sipër, KQZ ka kryer verifikimin në terren në lidhje me këto propozime ku ka konsistuar se, ambienti i propozuar nga KZAZ nr.88 është më afër QV e cila ka shërbyer për disa procese zgjedhore si QV dhe zgjedhësit e asaj qendre votimi kanë më shumë mundësi aksesit për të ushtruar të drejtën e tyre për të votuar. Gjithashtu duke marr parasysh dhe periudhën kur po mbahen zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie Himarë, ky ambient vjen në favor dhe është me afër nga zgjedhësit. KQZ ka administruar edhe dakordësinë e pronarit të objektit z. Odhise Milo, i cili është i gatshëm për të dhënë objektin për qendër votimi.

Nga shqyrtimi i të dhënave në dokumentacionin e administruar, rezulton se Bashkia Himarë nuk është në kushtet e ndryshimit të vendndodhjes së qendrës së votimit sipas rregullit të përcaktuar në nenin 62 pika 4 të Kodit Zgjedhor, për shkak se mungojne arsyet objektive.

Neni 62 pika 4 dikton qe vendndodhja e qendrës së votimit caktohet në të njëjtën adresë me atë të zgjedhjeve të fundit, me përjashtim të rastit kur për arsye objektive apo të parashikuara në nenin 93, kur kjo nuk është e mundur. Referuar dokumentacionit te propozuar nga KZAZ dhe te adminsitruar nga KQZ rezulton se ne zonen e qendres se votimit nr. 4589/00 ka propozime per ambjente te pershtatshme ne ambjente private qe mund te sherbejne si qender votimi.

Referuar inspektimit ne terren rezulton se vendndodhja e qendres se re te votimit eshte caktuar ne nje ambjent publik me nje distance rreth 3 km dhe nje kohezgjatje mesatare udhetimit te banoreve 25/30 minuta vajtje dhe po kaq ne kthim. Referuar listes se zgjedhesve rezulton qe moshja mesatare e zgjedhesve te kesaj qendre votimit eshte 50 vjec. Nga 691 zgjedhes rreth 312 zgjedhes jane te grupmoshes + 50 vjec. Periudhat zgjedhore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor janë ndërmjet datave 15 Prill – 15 Maj apo 15 Tetor – 15 Nëntor. Duke mbajtur parasysh që zgjedhjet nuk mbahen në asnjë prej këtyra periudhave zgjedhore, por do të zhvillohen, në sezon veror, me temperatura të larta dhe territorin e thyer, distanca e largët nga banesa te zona e tyre e qendres se votimit, veshitëson aksesin dhe mundësinë e zgjedhësve të kësaj qendre votimi për të ushtruar të drejtën e votës.

Referuar nenit 62 pika 11, KQZ ndërhyt kryesisht ose me ankesë të përfaqësuesve të partive



në KQZ, për të zbatuar kërkesat dhe kriteret për qendrën e votimit, numrin e zgjedhësve dhe vendndodhjen e tyre.

Ne kushtet kur propozimi përmbush kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr. 1, datë 05.12.2020 të Komisionit Rregullator “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjes së hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”, nenet 3 dhe 4 të tij, rekomandohet që vendodhja e qendrës së votimit të ndryshoje si vijon:

Ishte:

QV nr. 4589/00 me adrese Himarë, rr. Xhorxh Tened, nr. 4, shkolla 9-vjeçare “Nikolla Pano Meniko”, spile

Bëhet:

QV nr. 4589/00 me adrese Himarë, Lagjia 1 Maji, Rr. Milto Kallushi, ambjent privat i "Odhise Milos"

Për sa më sipër në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, i paraqitet për shqyrtim dhe miratim Projektvendimin “Për dhënie autorizimi për ndërrimin e vendndodhjes së QV nr. 4589/00, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024 ”.

Erion META

Drejtoria e Administratës Zgjedhore

Majlinda ÇELMETA

Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve

Majlinda ÇELMETA

Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data:07.2024

Nr: XX

Ora: MM:HH

PROJEKTVEKIM

PËR

**DHËNIE AUTORIZIMI PËR NDËRRIMIN E VENDNDODHJES SË QV NR. 4589/00,
PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË HIMARË TË
DATËS 4 GUSHT 2024**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenit 62, pika 4, nenit 93 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Dhënien e autorizimit për ndërrimin e vendndodhjes së QV nr. 4589/00 nga shkolla 9-vjeçare “Nikolla Pano Meniko”, Spile, Rr. Xhorxh Tened, nr. 4 në ambientin privat ne pronësi te shtetasit Odhise Milo me adrese Himarë, Lagjia 1 Maji, Rr. Milto Kallushi.
2. Kryetari i bashkisë të afishojë menjëherë listat e zgjedhësve në vendndodhjet e qendrave të votimit, sipas këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 24 (njëzet e katër) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: ... 07.2024 Nr:
Ora:



Për dhënie autorizimi për ndërrimin e vendndodhjes së qv nr. 4589/00, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024